



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

Dt. 27.06.2023

Raport pune për periudhën janar-qershor 2023

Në Komunën e Podujevës Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale punën e organizon në shërbimet primare shëndetësore- Sektori i Shëndetësisë, shërbimet sociale- sektori i Mirëqenies Sociale dhe Qendrën për Punë Sociale.

Raport i punës për periudhën janar-qershor 2023 në sektorin e shëndetësisë- QKMF

QKMF-ja ka punuar me kapacitete të plota bazuar në planin e punës për vitin 2023 edhe përkundër numrit jo të mjaftueshëm me resurse humane. Janë ofruar shërbime cilësore e gjithëpërfshirëse ndaj qytetarëve-popullatës konform obligimeve bazuar në dispozitat ligjore të Kujdesit Parësor Shëndetësor. E gjithë kjo nuk ishte e lehtë dhe ishte sfiduese por është arritur falë disiplinës e përkushtimit të profesionistëve e që kjo është inkurajuese edhe për mbarëvajtje e rezultate në vazhdim madje edhe me shtim e zgjerim shërbimesh.

-QKMF-ja ka ofruar dhe do të vazhdojë të ofrojë shërbime të mjekësisë familjare nga ora 07-23 çdo ditë pune, vikendeve dhe festave (kemi shtuar staf, para dite, pas dite dhe në mbrëmje me dy ekipa).

-Emergjenca dhe salla e infuzioneve kanë ofruar dhe do të ofrojnë shërbime 24 orë (edhe këtu kemi shtuar stafin).

-Materniteti ka ofruar dhe do të ofrojë shërbime 24 orë ku në kuadër të tij edhe Këshillimorja me orar 07-15 ditëve të punës.

-Specialistika ka punuar dhe do të vazhdojë të punojë çdo ditë pune 07-15 (Epidemiologu, Pulmologu, Gjinekologia, Pediatri, Radiologu) kuse nga tash shërbime specialistike do të ofrojnë vetëm: Epidemiologu, Pediatri, Radiologu dhe Gjinekologia ngase të tjerët janë pensionuar dhe Ligji i Kujdesit Parësor Shëndetësor nuk lejon zëvendësimin e tyre.

-Vaksinimi ka funksionuar dhe do të funksionojë nga ora 07-20 ditëve të punës dhe të shtunave nga ora 07-15 (Vaksinimi kryhet edhe në çdo qendër shëndetësore të terrenit ditëve të punës).

- Stomatologia ka punuar çdo ditë pune nga 07-20 dhe të shtunave 07-19 e të dielave 07-13. Stomatologia ka funksionuar edhe në QMF Lluzhan, Kërpimeh e Orllan çdo ditë pune para dite e

nga ky muaj edhe në AMF Gllamnik me 3 ditë pune para dite dhe me të kryer specializimin specializantët pas 2-3 muajve do të ofrohen shërbime çdo ditë pune.

-Radiologjia ka punuar dhe do të vazhdon punën nga ora 07-23 çdo ditë pune, festave dhe vikendeve, kurse ultrazëri e mamografia çdo ditë pune në orarin e para ditës 07-13.

-Laboratori në qendër punon çdo ditë pune, vikendeve e festave nga ora 07-23, në QMF Lluzhan, Orllan, Kërpimeh çdo ditë pune para dite e tashmë edhe në AMF Gllamnik me dy ditë pune para dite deri në rekrutim stafi ku do të punohet çdo ditë pune.

-Kujdesi shtëpiak-palativ ka punuar çdo ditë pune, festave dhe vikendeve nga ora 08-19 dhe jemi në planifikim të zgjatjes së orarit të këtij shërbimi deri në orën 23 posa të rekrutohet stafi.

-Nga muaji prill kemi filluar edhe me kujdesin shtëpiak geriatrik për persona të vetmuar pa përkujdesje familjare ku brenda dy muajve kemi identifikuar 17 raste.

-Kemi filluar dhe jemi duke vazhduar me programin e vizitave shtëpiake për gratë shtatzëna dhe fëmijët 0-3 vjeç nga ekipet e trajnuara me automjetin e dhuruar si donacion, ekipat tashmë janë pajisur edhe me laptopë e tabletë pune nga UNICEF-i.

-Kemi realizuar me sukses programin e dializës edhe përkundër shtimit të rasteve ku tashmë 2 muaj një nga këto raste bartet me autoambulancë në pozitë të palëvizshme.

- Njësia anticovid ka shkuar drejt zvogëlimit të stafit për shkak të zvogëlimit të rasteve të paraqitura ku tashmë funksionon vetëm testimi para dite.

- QMF-të në Lluzhan, Kërpimeh dhe Orllan punojnë me dy ndërrime dhe kujdestari, jemi në planifikim zgjerim orari në Lluzhan deri në orën 23 (këtu ofrohen shërbime të mjekësisë familjare me dy ndërrime, shërbime stomatogjike e laboratorike para dite çdo ditë pune)

-16 AMF janë funksionale me mjek në ato më të mëdha 3 ditë e ato më të vogla 2 ditë kurse me staf të mesëm çdo ditë pune në orarin 08-14:30.


-Nga marsi kemi filluar me punë në objektin e ri në Gllamnik me orarin para dite 07-15 të ekipës familjare: mjeke dhe dy infermiere, 3 ditë shërbime stomatologjike dhe 2 ditë shërbime laboratorike.

- Kemi rritë kapacitetet e punës në Lavatore me makinat e blera dhe donacion si dhe staf ku tash punohet me dy ndërrime, festave dhe të shtunave.

-Kemi shtuar stafin në barnatoren qendrore ku tash ofrohen shërbime para dite e pas dite si dhe festave e të shtunave.

-Kemi qenë mirë të furnizuar me barëra, material shpenzues, laboratorik, stomatologjik e radiologjik falë kontratës komunale, planifikimit dhe furnizimit nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë.

-Furnizimi me insulina ka qenë i mirë dhe vazhdon të jetë i tillë.



-Kemi vazhduar me dërgimin e stafit në trajnime të ndryshme ku vetëm në këtë periudhë kohore kemi rreth 70 të trajnuar për tema të ndryshme.

-Kemi realizuar vizitat sistematike të fëmijëve në çerdhet publike nga ekipa pediatrike dhe stomatologjike.

-Kemi realizuar vizitat sistematike të të gjithë nxënësve të klasëve të para, pesta dhe nënta të të gjitha shkollave nga ekipa stomatologjike dhe familjare.

-Kemi bërë pajisjen e shërbimeve si në qendër ashtu edhe teren me aparatura të reja, është bërë trajnimi i stafit për punë me këto aparatura, profesionistët janë pajisur me mjete pune, shërbimet me inventar dhe klima dhe janë krijuar ambiente të mira pune dhe kushte të reja për trajtim të pacientëve dhe punë të profesionistëve.

-Kemi filluar me aktivizimin e SISH-it dhe jemi në rrugë të mbarë të funksionalizimit të tij.

-Kemi aktivizuar sistemin e regjistrimit të hyrje daljeve për punëtorët e QKMF – së.

-Kemi rregulluar statusin e 7 vozitësve me konkurs të brendshëm konform dispozitave ligjore (të njëjtit me vite kryenin këtë punë dhe nuk paguheshin për të).

-Kemi rregulluar hapësirën për arkiv dhe është bërë sistemimi i dokumentacionit relevant, kemi adaptuar dhe rregulluar dhoma të veçanta të pushimit për higjieniste dhe punëtor teknik.

-Përmirësimet në infrastrukturë, pajisjet me aparatura e mjete pune, furnizimet e rregullta, trajnimet e stafit, rendi dhe rregulli i vendosur janë garancë e ofrimit të shërbimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse për qytetarët-popullatën dhe lehtësim për profesionistët për ofrim të shërbimeve.

STATISTIKË E SHËRBIMEVE TË KRYERA NË 6 MUJORIN E PARË TË KËTIJ VITI

Nr. i vizitave dhe shërbimeve mjekësisë familjare në qendër dhe teren	122488 vizita / 177967 shërbime
Nr. i vizitave në shërbimin e Emergjencës	25494 vizita
Nr. i intervenimeve shtëpiake nga Emergjenca	948 vizita në shtëpi
Nr. i vizitave në shërbimin e Maternitetit dhe Këshillimore	808 vizita gjinekologjike / 100 vizita në Këshillimore
Nr. i vizitave në shërbimin e Specialistikës Pediatri, Pulmologu, Oftalmologu	3195 vizita
Nr. i fotografimeve në Radiologji	8002 pacientë
Nr. i mamografive të kryera	173 pacientë
Nr. i echosonografive të kryera	482 pacientë
Nr. i vizitave Stomatologjike në qendër dhe teren	2999 vizita
Nr. i pacientëve që kanë kryer analiza laboratorike në qendër dhe teren	12615 pacientë
Nr. i vizitave shtëpiake të Kujdesit Paliativ	3845 vizita
Nr. i vizitave dhe shërbimeve të pacientëve të kujdesit Geriatrik	17 pacientë / 42 shërbime
Nr. i vizitave të grave shtatzëna dhe fëmijëve 0 – 3 vjeç	646 vizita
Nr. i të vaksinuarave në qendër dhe teren	3655 pacientë
Nr. i pacientëve me insulina dhe numri i shërbimeve	635 raste / 3128 shërbime
Nr. i rasteve në dializë dhe numri i shërbimeve	35 raste / 2100 shërbime
Nr. i vizitave sistematike të fëmijëve në çerdhet publike	112 fëmijë
Nr. i vizitave sistematike të nxënësve në shkolla (klasa e parë, e pestë dhe nëntë)	3642 nxënës
Nr. i testeve për Glikemi në këshillimore për Diabet dhe HTA	2100 pacientë

Sa i përket realizimit të projekteve janë në procedura si në vijim shumica kanë përfunduar procedurat dhe janë në fazën e realizimit e disa në fazën e vlerësimit:

- Projekti i furnizimit me uniforma ka përfunduar dhe të gjithë punëtorët e QKMF-së janë pajisur me to.
- Ka përfunduar në procedura të prokurimit projekti i servisimit të aparaturave radiologjike, stomatologjike dhe laboratorike-janë nënshkruar kontratat nga operatorët fitues.
- Projekti furnizim me pajisje mjekësore Lot-1:Furnizimi me rëntgen mobil për emergjencë dhe nevoja shtëpiake të pacientëve të palëvizshëm është realizuar.
- Projekti furnizim me pajisje mjekësore Lot-2:Furnizim me Vertebrogram për nevoja të radiologjisë aparaturë kjo për të zbuluar defektet e hershme të shtyllës kurrizore të moshat deri në 12 vjet është realizuar.
- Projekti furnizim me pajisje mjekësore Lot-3:Furnizim me pajisje stomatologjike, laboratorike dhe aparatura për raste emergjente është në procedurë të prokurimit.
- Projekti furnizim me pajisje mjekësore për Lot-4:Furnizim me klima dhe inventar për nevoja të shërbimeve është në realizim e sipër (nga OE është duke u bërë montimi i furnizimi dhe montimi i klimave).
- Projekti furnizim me oksigjen është në realizim
- Projekti furnizim me 10 bombola të 50 litrave për oksigjen është realizuar.
- Projekti servisim i automjeteve është në realizim
- Projekti furnizim me goma vere është realizuar.
- Projekti i mirëmbajtjes së liftave është në procedura të prokurimit.
- Projekti për mirëmbajtje të laurës, furnizim me kartela hyrëse për punëtor dhe furnizim me tiketa për hyrje-dalje është në procedura të prokurimit.
- Projekti furnizim me sistem të menaxhimit të radhës në mjekësi familjare Është në procedura të prokurimit.
- Projekti furnizimi dhe instalimi i kamerave është në realizim
- Është përfunduar projekti i furnizimit me automjete për nevoja të QKMF-së, është në fazën e liferimit:
 - *Autoambulancë për nevoja të emergjencës
 - *Automjet-kombi për bartje të rasteve të dializës.
 - *Autoambulancë e vogël për nevoja të shërbimit shtëpiak paliativ e geriatrik.
 - *Automjet i vogël pikap për nevoja të vaksinimit e punë teknike.
- Është valide për dy vite kontrata për furnizim me barëra, material hargjues, reagensa, filma të rëntgenit dhe material stomatologjik.
- Është në procedura të prokurimit në kuadër të kontratës komunale specifikacioni për furnizim me material higjienik për nevoja të QKMF-së.
- Jemi në shfrytëzim të kontratës nga AQP për furnizim me dokumentacion mjekësor dhe kemi inicuar procedurat në prokurim me specifikacion të veçantë në kuadër të kontratës komunale me dokumentacion që nuk figuron në kontratën e AQP-së.
- Jemi në fazën e implementimit të vendosjes së GPS -ve në automjetet e QKMF-së.
- Kemi inicuar procedurat e furnizimit me pelet në kuadër të kontratës komunale.
- Kemi inicuar me specifikacione në kuadër të kontratës komunale për material të mirëmbajtjes.

- Kemi dorëzuar në prokurim specifikacionet për furnizim me ID të punëtorëve.
- Ka kaluar projekti i renovimit dhe është shpallur fituesi, projekt ky që përfshin:
 - *Rregullimin, rrethimin e oborrit në QMF Lluzhan, parkingun dhe sportelin brenda.
 - *Rregullimin, rrethimin e oborrit dhe parkingun në AMF Lagje.
 - *Rregullimin e oborrit dhe parkingun në AMF Shtedim.
 - *Rregullimin e oborrit në AMF Sfeqël dhe nyjet sanitare.
 - *Rregullimin e oborrit në AMF Batllavë.
 - * Rregullimin e nyjeve sanitare në mjekësi familjare dhe emergjencë.
 - *Rregullimin e sporteleve të brendshme në QMF Kërpimeh dhe QMF Orllan.

Raport i punës për periudhën janar-qershor 2023 në sektorin e mirëqenies sociale

Donacionet:

- Me lëndë djegëse - dru janë ndihmuar 20 familje (me nga 4 m³ dru, 1 jorgan dhe 1 batanije për familje).
- Me shporet për ngrohje - janë ndihmuar 5 familje.
- Me stufë për ngrohje - janë ndihmuar 5 familje.
- Fondacioni “Shqiptarët për Shqiptarët” në krye me Elvis NAÇI në bashkëpunim me Komunën e Podujevës është duke ndihmuar mbi 40 familje në nevojë me shujtë ditore në vazhdimësi.
- Janë ndihmuar 790 familje me pako ushqimore, mish - pako higjienike, nga Donator, Shoqata dhe Organizata Humanitare (për festën e Kurban Bajramit).

Hapja e puseve me ujë të pijshëm:

- Në bashkëpunim me organizatën humanitare “Qatar Charity” është bërë hapja e puseve me ujë të pijshëm për 32 familje gjatë muajve janar–shkurt 2023 (projekt ky i vitit 2022).
- Gjatë muajit Prill organizata e lartëcekur ka shpreh gadishmëri që të bëhet hapja e puseve me ujë të pijshëm edhe për 28 familjet në nevojë, projekt ky i cili ka një specifik se puset duhet të hapen në një thellësi të kufizuar prej 50m (ky projekt është në procedurë të pritjes së nënshkrimit të marrëveshjes).

➤

Strehimi:

- Janë bërë 20 kërkesa për strehim të cilat janë vizituar dhe janë në proces të pritjes.
- 1 shtëpi është në ndërtim e sipër nga një donator.
- 22 shtëpitë e reja të ndërtuara për familjet raste sociale, janë në fazën përfundimtare të mobilimit ku së shpejti do tu ipen familjeve në shfrytëzim.

Subvencionet:

- Është bërë thirrja publike për OJQ-të në shumë prej 20,000.00 € në bazë të: RREGULLORES MF - NR – 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE.
- Komisioni në përbërje të plotë për Subvencione dhe Transferte i ngritur nga Kryetari i Komunës për muajin Janar – Shkurt 2023 ka vlerësuar aplikimet e palëve për subvencione me mjete financiare siç vijon:
 - Përfitues me vendime të përgjithësuara : 244 përfitues në shumë prej 39,650.00 €.
 - Përfitues me vendime të veçanta : 12 përfitues në shumë prej 12,500.00 €.

Raport i punës për periudhën janar-qershor 2023 në Qendrës për Punë Sociale

Shërbimet Sociale

Gjatë periudhës pesë mujore janar-maj 2023 në shërbimin social kemi pasur një fëmijë në strehim familjar në një komunë tjetër, Delikuencë të Miturve kemi pasur 20 raste, Dhunë në Familje 16 raste, 6 raste Bashkim Familjar, 3 raste Fëmijë me kujdestari, një rast Fëmijë në Adoptim, një Fëmijë nën Përkujdesje Familjare, 2 raste Besim të Fëmijëve, 4 raste kontakt Prind-Fëmijë, kemi lëshuar 53 vërtetime për rregullimin e Shtetësisë, 4 vërtetime Mbajtës të femiut për rregullimin e dokumenteve të udhëtimit, 4 Konstatime Zyrtare, Trajnime me temë :Reintegrimi- Integrimi i të huajve, Strehimi Rezidencial, Adoptimi, Abuzimi me fëmijët dhe Strehimi Familjar. Reintegrimi i të Riatdhesuarve nga Siria dhe Iraku

Asistenca Sociale

Në vazhdim ju paraqesim të dhënat për punën në periudhën kohore janar - qershor të vitit 2023-Kërkesat e reja për ndihmë sociale Për Ndihmë Sociale gjatë kësaj periudhe kohore nga qytetarët janë bërë 10 kërkesa të reja për ndihmë sociale. Prej tyre 7 janë aprovuar kurse 3 janë refuzuar. Numri i shfrytëzuesve të Ndihmës Sociale Janë gjithsej 732 Shfrytëzues të ndihmës sociale në qershor 2023.Riaplikimi- Gjatë periudhës kohore janar - qershor kanë riaplikuar 732 familje për ndihma sociale. Kërkesat për shqyrtim Shefit të Asistencës sociale në Podujevë i janë bërë 20 kërkesa për rishqyrtim, prej tyre janë pozitive 18, janë të refuzuara 2 lëndë. -Komisionit për ankesa pranë MPMS-së në Prishtinë i janë drejtuar 79 ankesa, prej tyre janë refuzuar 49 ankesa, janë aprovuar 18, kurse 12 në procedurë. Lëndët e Dërguara në Gjykatën Supreme -Në Gjykatën Supreme janë dërguar 3 Lëndë për të cilat është iniciuar procedura me Padi prej të cilave 3 janë në shqyrtim Kërkesat për ndihmë të njëhershme- Pranë QPS-në Podujevë janë bërë 0 kërkesa për ndihmë të njëhershme . Vërtetim për lirim nga pagesa e semestrit. Qendra për punë sociale ka bërë për muajin e Ramazanit 3 regjistra me mbi 446 shfrytëzues të asistencës sociale. 1-Rexhistri me pako ushqimore me 100 shfrytëzues të asistencës sociale. 2-Rexhistri me pako ushqimore me 10 shfrytëzues të asistencës sociale.nga donator privat.

Drejtoresh e DSHMS
Adelina Stublla

